



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.41

9 prill

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.215, datë 11.2.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.933, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe EUROPOL”	2131
Vendim i KM nr.216, datë 11.2.2009	Për një shtesë në vendimin nr.45, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”.....	2132
Vendim i KM nr.218, datë 6.3.2009	Për disa shtesa në vendimin nr.862, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a.”, të ndryshuar	2132
Vendim i KM nr.222, datë 27.1.2009	Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit të sipërfaqes 8300 m ² , nga “Albakër” sh.a. Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, dhe për një ndryshim në vendimin nr.336, datë 1.6.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi “Albakër” sh.a. të ndryshuar	2133
Vendim i KM nr.279, datë 12.3.2009	Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës private të arsimit të lartë, “Pavarësia”	2137
Vendim i GJK nr.8, datë 12.3.2009	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë.....	2138
Vendim i ERE nr.14, datë 6.3.2009	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Wonder Power” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	2139

Vendim i ERE nr.15, datë 6.3.2009	Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impianteve prodhuese (parqet eolik Visu dhe Terpan) si burime të rinovueshme energjie ...	2140
Vendim i ERE nr.16, datë 6.3.2009	Për propozimin e disa shtesave në “Modelin e tregut të energjisë elektrike”	2141
Vendim i ERE nr.17, datë 6.3.2009	Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar ...	2142
Vendim i ERE nr.18, datë 9.3.2009	Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për fillim të procedurave për rinovimin e licencës në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike	2143
Vendim i ERE nr.19, datë 9.3.2009	Mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për fillim të procedurave për rinovimin e licencës në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike	2144
Vendim i ERE nr.20, datë 9.3.2009	Për fillimin e procedurave të miratimit të rregullores për procedurat e regjistrimit në tregun, e energjisë elektrike	2144
Kërkesë e MPPTT nr.1535, datë 6.3.2009	Për shpronësim, për interers publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Kavajë”.....	2145
	Ndreqje gabimi	2147

VENDIM
Nr.215, datë 11.2.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.933, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFAQËSIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME ME OFICERË
KONTAKTI NË BRITANINË E MADHE, BELGJIKË, ITALI, GREQI, TURQI, KOSOVË DHE
EUROPOL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.933, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti, në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Francë dhe EUROPOL”.

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti, pranë ministrive homologe, në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Francë, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, për të mbështetur luftën e përbashkët kundër trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike, terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të armëve, emigracionit të paligjshëm dhe pastrimit të parave.”.

c) Pika 3 shfuqizohet.

ç) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Ministri i Brendshëm përcakton numrin e oficerëve të kontaktit sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, të cilët mund t'i ngarkojë për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme në më shumë se 1 (një) vend.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.216, datë 11.2.2009

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.45, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK NË MËNYRË
ELEKTRONIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 1 të vendimit nr.45, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të shtohen edhe këto fjalë:

“... me përjashtim të procedurave të prokurimit, me objekt “Blerja e energjisë elektrike” dhe “Menaxhimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve, si dhe operimi i tunelit të Thirrës, në autostradën Rrëshen-Kalimash”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.218, datë 6.3.2009**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.862, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES” SHA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 168 e vijues, e 181 e vijues, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.862, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 5 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nga ky rregull bëjnë përjashtim kreditë, ndërmjet KESH sh.a. dhe Bankës Europiane të Investimit, në shumën 2,3 (dy presje tre) miliardë lekë, dhe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, në shumën 2,68 (dy presje gjashtëdhjetë e tetë) miliardë lekë, sipas specifikimeve, të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, detyrimet e të cilave nuk do t’i transferohen OSSH, sh.a.”.

2. Pas pikës 5/2 shtohen pikat 5/3, 5/4 e 5/5, me këtë përmbajtje:

“5/3. Asetet e financuara nga kreditë afatgjata, të përfunduara gjatë vitit 2008, nga KESH sh.a. për OSSH sh.a. në shumën 1,1 (një presje një) miliardë lekë, t’i transferohen Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. dhe të regjistrohen në pronësi të këtij operatori.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ta pasqyrojë këtë transferim në formën e uljes së kapitalit të KESH sh.a. dhe të rritjes së kapitalit të OSSH sh.a. përkatësisht në vlerën e

përcaktuar më lart.

5/4. Detyrimet afatshkurtra, për blerjen e energjisë elektrike dhe tarifën e transferimit, që OSSH sha, ka, respektivisht, ndaj KESH, sha, dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. deri në shumën 1 (një) miliard lekë, të shuhet dhe të pasqyrohet si rritje kapitali e OSSH, sh.a.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kryejë veprimet e nevojshme, për pasqyrimin e këtij veprimi.

5/5. Shuma prej 0,53 (zero presje pesëdhjetë e tre) miliard lekë, që i korrespondon pagimit të huave afatgjata, në vitin 2008, nga KESH sh.a. të pasqyrohet si rritje kapitali për OSSH sh.a.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kryejë veprimet e nevojshme për pasqyrimin e këtij veprimi.”.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.222, datë 27.1.2009

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË SIPËRFAQES 8300 M², NGA ALBAKËR SHA, MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.336, DATË 1.6.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ALBAKËR SHA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit të sipërfaqes 8300 (tetë mijë e treqind) m², me vlerë kontabël 2 656 000 (dy milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, nga “Albakër” sh.a. në likuidim e sipër, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për shesh ndërtimor, për ndërtimin e segmentit rrugor “Milot-Rrëshen”.

2. Kjo sipërfaqe, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme të Albakër sh.a. të miratuar me vendimin nr.336, datë 1.6.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Albakër sh.a.”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, që, përpara fillimit të punimeve në pjesën e territorit të uzinës, që do të përdoret si shesh ndërtimi:

a) të ndërtojë murin rrethues të uzinës së rafinimit të bakrit, Rubik, në kufijtë e territorit, që mbetet në administrim të uzinës;

b) të ndërtojë rrjetin nëntokësor të furnizimit me ujë të uzinës, që ndodhet në sheshin e ndërtimit, që i kalon në administrim të DPRR-së, sipas projektit të miratuar nga Albakër sh.a. në likuidim.

4. Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit i ndalohej të ndryshojë

destinacionin e kësaj prone.

5. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

[illegible]


Andi TOMA

Dreijer i Pergithshem

"MILOT-RRESHEN" HIG
"DURRES - MORINE" COI
LOT 2

RUBIK, INTERCHANGE
GENERAL LAYOUT

[illegible]



MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTI
TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PERCJITHSHME E RRUGE

Ardi TOMA

Drejtor i Pergjithshem

"MILOT-RRESHEN" HIGHWAY "DURRES - MORINE" CORRIDOR LOT 2		egis route Address: 16 1215 0000 0000 Phone: 00355 22 22 22 22 Fax: 00355 22 22 22 22 E-mail: info@egisroute.com	
PUB. INTERCHANGE GENERAL LAYOUT		1:1 000 A3	From Ks 15+400 To Ks 17+400

VENDIM
Nr.279, datë 12.3.2009

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË,
“PAVARËSIA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës private të arsimit të lartë “Pavarësia”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Vlorës.

2. Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia”, do të organizohet në dy fakultete:

a) Në Fakultetin e Ekonomisë dhe të Shkencave Shoqërore, me programet e studimit në “Drejtësi”, “Ekonomi” dhe “Shkenca politike”, në formën e studimeve me kohë të plotë;

b) Në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, me programet e studimit, “Inxhinieri informatike” dhe “Arkitekturë”, në formën e studimeve me kohë të plotë.

3. Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia”, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, do të ofrojë programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë për “Arkitekturë”, i cili do të zgjasë 5 vite, dhe në mbarim të tij do të lëshojë “Diplomë të integruar, të nivelit të dytë” (DIND), në “Arkitekturë”, ndërsa programi tjetër i këtij fakulteti dhe programet e fakultetit të Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore do të jenë programe studimi, të ciklit të parë, të cilat do të zgjasin 3 (tri) vite dhe në mbarim të tyre do të lëshojnë “Diplomë të nivelit të parë (DNP)”, përkatësisht, në:

c) Drejtësi

d) Ekonomi;

e) Shkenca politike;

ç) Inxhinieri informatike.

4. Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia”, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga personel akademik i huaj, me kualifikim të nevojshëm.

5. Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, të bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.8, datë 12.3.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 24.2.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.26/12 Akti që i përket:

KËRKUES: Gjergji Habilaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Administratorët e Shoqërisë “Vefa” sh.p.k., zyra e përmbarimit, TIRANË

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

VËREN:

Kërkuesi, me vendimin nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është shpallur kreditor te shoqëria “Vefa” sh.p.k. në administrim për shumën 42 830 484 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi pala e paditur nuk ka ushtruar ndaj tij rekurs brenda afatit 30-ditor.

Me vendimin nr.114, datë 10.11.2005, Gjykata e Apelit Tiranë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit të mësipërm dhe zyra e përmbarimit gjyqësor ka filluar procedurat e ekzekutimit të vendimit që në janar të vitit 2006.

Administratorët e Shoqërisë “Vefa” i janë drejtuar Gjykatës së Lartë duke kërkuar fillimisht rivendosjen në afat dhe më pas rishikimin e vendimit nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit. Këto kërkesa nuk janë pranuar nga Gjykata e Lartë.

Më pas, ata i janë drejtuar Gjykatës së Apelit me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor. Kjo Gjykatë, me vendimin nr.37, datë 2.5.2006 ka rrëzuar padinë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr.16, datë 22.1.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit.

Vendimi gjyqësor i formës së prerë, edhe pas këtyre proceseve gjyqësore, nuk është ekzekutuar.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese më datë 9.5.2008, kërkuesi kërkon konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Në seancën plenare, më datë 24.2.2009 kërkuesi hoqi dorë nga kërkesa e tij, duke u shprehur se gjykimi i mëtejshëm i çështjes nuk paraqet interes për të. Heqjen dorë nga kërkesa kërkuesi e ka depozituar edhe me shkrim pranë Gjykatës më datë 26.1.2009.

Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se “Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë

procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.” Bazuar në këtë dispozitë, Gjykata Kushtetuese iu referua Kodit të Procedurës Civile (KPC), neni 299/b, i cili parashikon se “gjykata vendos pushimin e gjykimit nëse paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë” .

Në kushtet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të KPC.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 1 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dhe nenin 299 të KPC, njëzëri,

VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Kujtim Puto, Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi

VENDIM

Nr.14, datë 6.3.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT PËR LICENCË TË SHOQËRISË “WONDER POWER” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pikat 1 germa “d”, dhe 8 pika 2 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe të nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 6.3.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Wonder Power” sh.a. për fillim të procedurave për licensim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Dhe konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Wonder Power” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b” dhe “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për të gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit dhe aplikimit për licencë të shoqërisë “Wonder Power” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.15, datë 6.3.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “ALB WIND ENERGY” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE (PARQET EOLIK VISU DHE TERPAN) SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë Elektrike nga burimet e rinovueshme”, neni 8, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ALB WIND ENERGY” sh.p.k. për kualifikimin e impianteve prodhuese (parqet eolik Visu dhe Terpan) si burime të rinovueshme energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë “ALB WIND ENERGY” sh.p.k.

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impianteve prodhuese (parqet eolike Visu dhe Terpan) si burime të rinovueshme energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.16, datë 6.3.2009

PËR PROPOZIMIN E DISA SHITESAVE NË “MODELIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 9 dhe të nenit 53, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2009, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe të Drejtorisë Juridike dhe

Mbrojtjes së Konsumatorit për disa ndryshime në modelin e tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 dhe konstatoi nevojën e përcaktimit në modelin e tregut të energjisë elektrike të një minimumi të lejueshëm të disbalancave, devijimeve, për të cilat pjesëmarrësit e tregut nuk paguajnë sanksione,

VENDOSI:

1. Miraton propozimin për disa shtesa në “Modelin e tregut të energjië elektrike”, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, të cilat do t’i propozohen për miratim Këshillit të Ministrave, me përmbajtjen si më poshtë:

A. Në pikën 5.4, në fund të fjalisë shtohet paragrafi:

Disbalancat (devijimet) nga programi javor në masën +/- 5%, do të konsiderohen si disbalanca (devijime) për të cilat pjesëmarrësit e tregut nuk do të paguajnë sanksione, por ato janë të detyruara që për javën/javët pasardhëse të planifikojnë rregullimin e këtyre disbalancave (devijimeve).

B. Në pikën 6.1, paragrafi i fundit – të arkëtueshme/të pagueshme, të vedoset +/- 5%.

C. Në pikën 6.2, paragrafi i fundit – të arkëtueshme/të pagueshme, të vedoset +/- 5%.

D. Në pikën 6.4, paragrafi i fundit – të arkëtueshme/të pagueshme, të vedoset +/- 5%.

E. Në pikën 6.5, paragrafi i fundit – të arkëtueshme/të pagueshme, të vedoset +/- 5%.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.17, datë 6.3.2009

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN PËR KRITERET E DHËNIES DHE HEQJES SË STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pikës 7 të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2009, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe

Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar si më poshtë:

a) Në nenin 2, në fillim të fjalisë pas fjalës “të gjithë” hiqen fjalët klientë tariforë dhe vendoset fjala subjektet.

b) Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

Pika 1, aty ku thuhet ERE ndryshon dhe bëhet: “Enti Rregullator i Energjisë”.

Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me përmbajtjen:

“3/1. Subjekt në kuptim të kësaj rregulloreje do të thotë një person fizik ose juridik që kërkon të përfitojë statusin e klientit të kualifikuar”.

Pika 5 ndryshon dhe bëhet:

“OSSH është personi i licencuar për të kryer veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe atë të furnizimit publik me pakicë”.

Pika 6 ndryshon dhe bëhet:

“OST është personi i licencuar për të kryer veprimtaritë e transmetimit të energjisë elektrike, dispeçerimit të sistemit elektroenergjetik, si dhe për operimin e tregut të energjisë elektrike”.

Pika 7 shfuqizohet.

c) Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

Germa “a”) ndryshon dhe bëhet:

Plotëson kriterin e vendosur vit pas viti nga Bordi i Komisionerëve në zbatim të nenit 48, pika 1”.

Germa “b”) ndryshon dhe bëhet:

“Paraqet në ERE kopje të noterizuar të librezës së pagesave të energjisë elektrike dhe kopje të faturave të energjisë elektrike, të noterizuara, për vitin e mëparshëm, sipas të cilave ka likuiduar detyrimet ndaj OSSH deri në momentin që aplikon në rastin e klientëve ekzistues.”.

Germa “c”) ndryshon dhe bëhet:

“Subjekti demonstroi në ERE kategorinë e klientit të cilës ai i përket apo do t’i përkasë.”.

d) Në nenin 5 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në pikën 1, në fillim të fjalisë bëhet:

“Çdo subjekt ekzistues apo i perspektivës”

Pika 2 shfuqizohet.

Pika 3 bëhet pika 2 dhe ka përmbajtjen:

“Brenda 20 ditëve nga marrja e kërkesës, Bordi pasi konstaton rregullshmërinë e aplikimit, vendos për dhënien ose jo të statusit të klientit të kualifikuar.”.

e) Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

“Në pikën 1, pas fjalëve “duhet të njoftojë” hiqet fjala “Furnizuesin” dhe vendoset “OSSH.”.

Në pikën 2 në fund të fjalisë shtohen fjalët:

dhe të njoftojë OSSH apo OST, si dhe KESH/FPSH dhe ERE-n”.

f) Në nenin 7 shfuqizohet germa “b”),

g) Në nenin 8, në pikën 1 dhe 3, aty ku thuhet “furnizuesin publik”, ndryshon dhe bëhet “OSSH.”.

gJ) Në nenin 10, në titullin e nenit dhe në paragrafin e parë ku thuhet “Furnizuesin publik” bëhet “OSSH/furnizuesi publik me pakicë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.18, datë 9.3.2009

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST SHA TË PËR FILLIM TË PROCEDURAVE PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pika 3 dhe nenit 16 të rregullores “Për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1 germa “a” të rregulloreve të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. “Për fillim të procedurave për rinovimin e licensës në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike” dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e licensës në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike për shoqërinë “OST” sh.a.

2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.19, datë 9.3.2009

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË KESH SHA PËR FILLIM TË PROCEDURAVE PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pika 3 dhe nenit 16 të rregullores “Për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1 germa “a” të rregulloreve të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a “Për fillim të procedurave për rinovimin e licensës në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike” dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licensave”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike për shoqërinë “KESH” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.20, datë 9.3.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË MIRATIMIT TË RREGULLORES PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, nenit 18 pika 1 germa “g”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.68, datë 23.6.2008 “Për miratimin e rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike” pika III.1, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2009, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e OST sh.a. “Për miratimin e rregullores për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e rregullores “Për Procedurat e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrotjtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepravishta

KËRKESË

Nr.1535, datë 6.3.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interers publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Kavajë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni

konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 9 243 080 (nëntë milionë e dyqind e dyzet e tre mijë e tetëdhjetë)lekë.

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS “UNAZA KAVAJË”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.		Sipërf.	Lloji i pasurisë					Shuma (Lekë)	Shënime
					Nr.	përgji	Truall			Objekt			
							pasurisë	m²	m²	Çmimi	VL.(Lekë)		
1	Idajet	Halim	Gjylsheni	8552	10/199	131.3	43	17982	773226			773226	konf.zvrpp
2	Vath	Halim	Gjylsheni	8552	10/200	570	43	17982	773226			773226	konf.zvrpp
3	Fadil	Hysen	Lushkja	8551	9/107	725	23	15763	362549			362549	konf.zvrpp
4	Azem	Murat	Lushkja	8552	14/156	417	31	15763	488653			488653	proc.regjis.
5	Trashigimt	Ramazan	Arap	8552	13/174	244	36	15763	567468			567468	proc.regjis.
6	Besnik	Haxhi	Qerosi	8552	13/93	200	82	15763	1292566			1292566	proc.regjis.
7	Muharrem	Hamdi	Cela	8552	17/104	256.3	22	15763	346786	banesë	2273317	2620103	proc.regjis.
8	Maksim	Qamil	Beja	8552	9/175	181.5	35	17982	629370			629370	konf.zvrpp
9	Mehmet	Rrahman	Jakupi	8552	13/102	878	8	15763	126104			126104	konf.zvrpp
10	Arben		Gjini	8552	10/203	716	8	17982	143856			143856	proc.regjis.
11	Rasim		Bali	8552	17/50	460	63	15763	993069			993069	proc.regjis.
12	Ali	Avdyl	Jaupi	8552	15/102	170	23	15763	362549			362549	proc.regjis.
13	Skënder	Qerim	Kazazi	8552	13/14	210	7	15763	110341			110341	proc.regjis.
	Shuma:						424		6969763		2273317	9243080	

Ndreqje gabimi

Në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i botuar në Fletoren Zyrtare nr.189, datë 29.12.2008 të bëhet kjo ndreqje gabimi:

- **Në nenin 6, pika 6, shifra “2” zëvendësohet me shifra “1”.**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 9.4.2009
Doli nga shtypi më 9.4.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 20 lekë